

# **INSO ALBANIA SHPK**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021**

# Përmbajtja

	<u>Faqe</u>
Pasqyra e pozicionit financiar	1-2
Pasqyra e performancës financiare	3
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e flukseve monetare	5
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	6
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare	7-16

**INSO ALBANIA Shpk**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
(shumat në Lek)

Nr	Aktivitet	Shenime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
	<b>Aktivitet fatshkurtra</b>			
	▶ <b>Aktivitet monetare</b>			
1	Banka	3	166,993,418	131,153,880
2	Arka		32,243	56,846
	▶ <b>Investime</b>			
1	Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit			
2	Aksionet e veta			
3	Të tjera financiare			
	▶ <b>Të drejta të arkëtueshme</b>			
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	4	101,677,578	59,342,962
2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit			
3	Nga njësitë ku ka interesa pjesëmarrëse			
4	Të tjera	5	34,432,712	29,936,439
5	Kapital i nënshkruar i papaguar			
	▶ <b>Inventarët</b>			
1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme			
2	Prodhime në proces dhe produkte gjysëm të përfunduara			
3	Produkte të gatshme			
4	Mallra			
5	Aktive biologjike			
6	AAGJM të mbajtura për shitje			
7	Parapagime për inventar			
	▶ <b>Shpenzime të shtyra</b>	6	69,244,452	78,387,464
	▶ <b>Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara</b>			
<b>I</b>	<b>Totali aktiveve afashkurtra</b>		<b>372,380,403</b>	<b>298,877,591</b>
	<b>Aktivitet afatgjata</b>			
	▶ <b>Aktivitet financiare</b>			
1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit			
2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit			
3	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
4	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata			
6	Tituj të tjerë të huadhënies			
	▶ <b>Aktivitet materiale</b>			
1	Toka dhe ndërtesa			
2	Impiante dhe makineri	7	680,911	885,229
3	Të tjera instalime dhe pajisje			
4	Parapagime për aktive materiale dhe punë në proces			
	▶ <b>Aktivitet biologjike</b>			
	▶ <b>Aktivitet jo materiale</b>			
1	Koncesione, patenta, liçenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme	8	129,054	152,891
2	Emri i Mirë			
3	Parapagime për AAJM			
	▶ <b>Aktive tatimore të shtyra</b>			
	▶ <b>Kapital i nënshkruar i papaguar</b>			
<b>II</b>	<b>Totali aktiveve afatgjata</b>		<b>809,965</b>	<b>1,038,120</b>
	<b>Aktive totale</b>		<b>373,190,368</b>	<b>299,915,711</b>

**INSO ALBANIA Shpk**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar (vazhdim)**  
 (shumat në Lek)

Nr	Detyrimet dhe kapitali	Shenime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
	<b>► Detyrime afatshkurtra:</b>			
1	Titujt e huamarrjes			
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë			
3	Arkëtime në avancë nga klientët			
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	9	222,809,411	139,794,200
5	Dëftesa të pagueshme			
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit			
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	10	302,201	219,311
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	11	1,082,490	2,438,869
10	Të tjera të pagueshme	12	19,666,605	
	<b>► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>	13	<b>4,603,464</b>	
	<b>► Të ardhura të shtyra</b>	14	<b>54,261,226</b>	<b>55,582,261</b>
	<b>► Provizione</b>			
<b>I</b>	<b>Totali i Detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>302,725,398</b>	<b>198,034,641</b>
	<b>► Detyrime afatgjata</b>			
1	Titujt e huamarrjes			
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë			
3	Arkëtimet në avancë nga klientët			
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit			
5	Dëftesa të pagueshme			
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit			
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
8	Të tjera të pagueshme			
	<b>► Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>			
	<b>► Të ardhura të shtyra</b>			
	<b>► Provizione</b>			
1	Provizione për pensionet			
2	Provizione të tjera			
	<b>► Detyrime tatimore të shtyra</b>			
<b>II</b>	<b>Totali i Detyrimeve afatgjata</b>			
	<b>Detyrime totale</b>			
	<b>► Kapitali dhe Rezervat</b>			
	<b>► Kapitali i Nënshkruar</b>	15	<b>4,000,000</b>	<b>4,000,000</b>
	<b>► Primi i lidhur me kapitalin</b>			
	<b>► Rezerva rivlerësimi</b>			
	<b>► Rezerva të tjera</b>	16		
1	Rezerva ligjore			
2	Rezerva statutoe		3,780,396	3,780,396
3	Rezerva të tjera		149,173,642	149,173,642
	<b>► Fitimi i pashpërndarë</b>	17	<b>-55,072,967</b>	<b>-39,850,692</b>
	<b>► Fitimi/(humbja) e vitit</b>	18	<b>-31,416,100</b>	<b>-15,222,275</b>
	<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>70,464,971</b>	<b>101,881,070</b>
<b>III</b>	<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>373,190,368</b>	<b>299,915,711</b>

Shënimet e paraqitura në faqen 7 deri në faqen 16 janë pjesë përberëse e këtyre pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi Drejtues i "Inso Albania" Shpk më 17 Mars 2022, dhe janë nënshkruar nga:

Nikolaos Lekatsas  
 Administrator

*STUDIO PUSTINIA*  
 Studio Kontabel  
*STUDIO PUSTINIA SHPK*  
 Nr. «Abdy» Frashëri 31, Pallati  
 i «Inso» Tiranë



**INSO ALBANIA Shpk**  
**Pasqyra e performancës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor**  
 (shumat në Lek)

	Shënime	2021	2020
▶ <b>Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>	19	<b>543,582,141</b>	<b>340,106,352</b>
▶ <b>Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces</b>			
▶ <b>Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar</b>			
▶ <b>Të ardhura të tjera të shfrytëzimit</b>			
▶ <b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>			
1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme			
2 Të tjera shpenzime			
▶ <b>Shpenzime të personelit</b>	20		
1 Paga dhe shpërblime		-18,224,528	-19,205,774
2 Shpenzime të sigurimeveshoqërore/ shëndetsore		-1,596,379	-1,539,963
▶ <b>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</b>			
▶ <b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	7+8	<b>-228,155</b>	<b>-261,911</b>
▶ <b>Shpenzime të tjera shfrytëzimi</b>	21	<b>-554,399,992</b>	<b>-334,426,872</b>
▶ <b>Të ardhura të tjera financiare</b>			
1 Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)			
2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)			
3 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera (të ardhura të paraqitura veçmas nga njësitë ekonomike brenda grupit)			
▶ <b>Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra</b>			
▶ <b>Shpenzime financiare</b>			
1 Shpenzime interesi nga njësitë brenda grupit			
2 Shpenzime të tjera financiare	22	-549,187	105,893
▶ <b>Pjesa e fitimit/(humbjes) nga pjesëmarrjet</b>			
▶ <b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		<b>-31,416,100</b>	<b>-15,222,275</b>
▶ <b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>			
1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		0	0
2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë			
3 Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve			
▶ <b>Fitimi/(humbja) e vitit</b>		<b>-31,416,100</b>	<b>-15,222,275</b>
▶ <b>Fitimi/(humbja) për:</b>			
1 Pronarët e njësisë ekonomike			
2 Interesat jo-kontrolluese			

Shënimet në faqet 7 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**INSO ALBANIA Shpk****Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor**

(shumat në Lek)

	2021	2020
<b>► Fitim/(Humbja) e vitit</b>	<b>-31,416,100</b>	<b>-15,222,275</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:		
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		
Të ardhura gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		
<b>► Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		
<b>► Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-31,416,100</b>	<b>-15,222,275</b>
<b>► Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për:</b>		
<i>Pronarët e njësisë ekonomike</i>	-	-
<i>Interesat jo-kontrolluese</i>	-	-

Shënimet në faqet 7 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**INSO ALBANIA Shpk**  
**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare**  
(shumat në Lek)

	<b>Shënime</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
<b>► Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>			
<i>Fitim/(humbja) para tatimit</i>		-31,416,100	-15,222,275
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>			
<i>Shpenzimet jomonetare</i>			
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin</i>			
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		228,155	261,911
<i>Shpenzime te konstatuara</i>			
<i>Te ardhura te konstatuara</i>			
<i>Humbje nga shitja e aktiveve</i>			
<i>Të ardhurat nga interesi</i>			
<i>Shpenzime interesi</i>			
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>			
<b>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitete</b>			
<i>Shumat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>			
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>			
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		-37,687,879	8,322,177
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>			
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		106,011,792	-17,893,876
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e tjera</i>		-1,321,034	918,761
<b>Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>35,814,934</b>	<b>-23,613,303</b>
<b>► Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktivitetet e investimit</b>			
<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>			
<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>			
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>			-134,250
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>			
<i>Pagesa për blerjen e aktive afatgjata jomateriale</i>			
<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>			
<i>Dividentë të arkëtuara</i>			
<i>Hua të disbursuara</i>			
<i>Arkëtime nga huatë</i>			
<b>Mjete monetare neto përdorur në aktivitetet e investimit</b>			<b>-134,250</b>
<b>► Fluksi i Mjeteve Monetare përdorur në aktivitetet e financimit</b>			
<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>			
<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>			
<i>Hua të arkëtuara</i>			
<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>			
<i>Riblerje e aksioneve të veta</i>			
<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>			
<i>Pagesa e huave</i>			
<i>Pagesa për detyrimet e qirasë financiare</i>			
<i>Interes i paguar</i>			
<i>Dividendë të paguar</i>			
<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet e financimit</b>		<b>0</b>	
<b>Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë</b>		<b>35,814,934</b>	<b>-23,747,553</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë më 1 janar 2020</b>		131,210,726	154,958,279
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor 2020</b>	3	<b>167,025,660</b>	<b>131,210,726</b>

Shënimet në faqet 7 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**INSO ALBANIA Shpk**
**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor**

(shumat në Lek)

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitimi vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
► <b>Pozicioni financiar më 1 janar 2020, sipas raportimit të mëparshëm</b>	<b>4,000,000</b>					<b>37,853,212</b>	<b>-39,850,692</b>	<b>115,100,826</b>	<b>117,103,345</b>	<b>0</b>	<b>117,103,345</b>
Korigjimi i gabimit (referohuni shenimit 20)											
<b>Pozicioni financiar i korigjuar me 1 janar 2020</b>	<b>4,000,000</b>					<b>37,853,212</b>	<b>-39,850,692</b>	<b>115,100,826</b>	<b>117,103,345</b>	<b>0</b>	<b>117,103,345</b>
Fitimi i vitit, sipas raportimit të mëparshëm								-15,222,275	-15,222,275	0	-15,222,275
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>											
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>											
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike:</b>											
Transferimi i fitimit						115,100,826		-115,100,826	0	0	0
Rritje kapitali											
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>											
► <b>Pozicioni financiar më 1 janar 2021</b>	<b>4,000,000</b>					<b>152,954,037</b>	<b>-39,850,692</b>	<b>-15,222,275</b>	<b>101,881,070</b>	<b>0</b>	<b>101,881,070</b>
Fitim humbja e vitit								-31,416,100	-31,416,100		-31,416,100
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>											
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>											
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike:</b>											
Transferimi i fitimit të vitit të mëparshëm							-15,222,275	15,222,275	0	0	0
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>											
► <b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021</b>	<b>4,000,000</b>					<b>152,954,037</b>	<b>-55,072,967</b>	<b>-31,416,100</b>	<b>70,464,970</b>	<b>0</b>	<b>70,464,970</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri në 16 janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.



## **1. Njësia raportuese**

Inso Albania shpk (Shoqëria) është krijuar më 15 Dhjetor 2006 dhe është regjistruar, me numrin e identifikimit K62421003A. Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rruga Abdyl Frasheri, Pallati 31 (Hekla). Objekti i shoqërisë është: Projektimi dhe ndertimi i zyrave dhe infrastrukturave, ne veçanti ne sektorin sanitar, projektimi, furnizimi, instalimi i paketave te veglave elektromjeksore dhe te mirembajtjes se tyre, konsulenee dhe asistence ne infrastrukture dhe sherbime sociale etj.

Përfaqësuesi ligjore i shoqërisë është Z. Nikolaos Lekatsas.Numri i personelit më 31 dhjetor 2021 është 8 (31 dhjetor 2020: 9).

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).Detajet e politikave të rëndësishme kontabël të Shoqërisë janë përfshirë në Shënimin 3.

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin shoqëria kryen aktivitetin e saj.

### **2.4 Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë ne aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

#### **2.4.1 Gjykime**

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, përfshihet më poshtë:

Parimi i vijimësisë:Drejtimi i përgatiti këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Në kryerjen e këtij gjykimi, drejtimi kreu një analizë të hollësishme duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat në dispozicion dhe pozicionin financiar të Shoqërisë, qëllimet aktuale, përmirësimin e pritshëm të përfitimit të operacioneve dhe aksesin në burimet financiare të grupit, në mënyrë që të konkludojë nëse Shoqëriamund të vazhdojë të funksionojë në përputhje me parimin e vijimësisë në të ardhmen e parashikueshme. Nën "të ardhmen e parashikueshme", drejtimi merr në konsideratë të gjitha informacionet e disponueshme për të ardhmen, e cila është të paktën, por nuk kufizohet në, dymbëdhjetë muaj nga përfundimi i periudhës së raportimit. Përfundimi nga analiza e mësipërme është se Shoqërianuk përballet me ndonjë problem operimi dhe nuk parashikon ndonjë të tillë deri në fund të vitit 2021.

### **3. Politikat kontabël**

Politikat e mëposhtme kontabël janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

#### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të momentit kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten bazuar në koston historike në monedhë të huaj, përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga konvertimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje.

Monedha Euro (e cila është monedha kryesore me të cilën operon shoqëria) u konvertua me kursin 120.76 (2020: 123.7) Lekë.

#### **3.2 Instrumentet financiarë**

Instrumentet financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë joderivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur në thelb kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtër me bankat, të cilat fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozitat pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre.

##### *Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Një provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme regjistrohet kur ekzistojnë prova objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në afatet fillestare të përcaktuara. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të riorganizohet financiarisht konsiderohen tregues që llogaria e arkëtueshme është zhvlerësuar. Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuar, të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit.

##### *Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera*

Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **3.2 Instrumentet financiarë (vazhdim)**

##### *Huamarrjet*

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë minus kostot e transaksionit ndërsa më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*

Titujt e pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse njihen fillimisht me kosto, dhe më pas maten me kosto minus humbjet nga zhvlerësimi.

##### *Të tjera*

Instrumente të tjerë financiarë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Vlera e drejtë*

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, minus çdo zhvlerësim, supozohen të jenë të përafërta me vlerat e tyre kontabël.

#### **3.3 Aktive afatgjata materiale**

##### **3.3.1 Aktivet afatgjata materiale**

###### **(i) Njohja dhe matja**

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet.

Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nqs përfshihet), çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të kryera gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtime në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrjet jashtë përdorimit të një zëri përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur të aktivitet, dhe njihen neto në "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

###### **(ii) Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

###### **(iii) Amortizimi**

Amortizimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën rënëse për të gjitha aktivitet afatgjata materiale, mbi jetën e dobishme të vlerësuar të secilës pjesë të një aktivitet afatgjatë material duke nisur nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Jetëgjatësia e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metodat përkatëse të amortizimit janë si më poshtë:

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma amortizimit
Pajisje IT	Vlera e mbetur	25%
Te tjera instalime dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### **3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **3.4 Zhvlerësimi**

#### **(i) Aktivet financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **(ii) Aktivet jo-financiare**

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese mjetesh monetare (CGU) është më e madhja midis vlerës së saj në përdorim dhe vlerës së drejtë të saj minus kostot e shitjes. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara monetare skontohe duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Për qëllime të testimit të zhvlerësimit, aktivet grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë hyrje të mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm, të cilat janë të pavarura nga hyrjet në mjete monetare të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve (“CGU”).

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e “CGU” së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga zhvlerësimi në lidhje me “CGU” janë shpërndarë për të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve në njësi (grup njësis) në baza proporcionale. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periodat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë indikacion se humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet vetëm në atë masë që vlera kontabël neto e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar, duke zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

### **3.5 Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe ka një mundësi që të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### **3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat në lidhje me ndërtimin njihen me kalimin e kohës, në përputhje me politikën kontabël të Shoqërisë. Shoqëria do të shqyrtojë dhe, kur është e nevojshme, rishikojë vlerësimet e të ardhurave dhe kostove kur transaksioni i shërbimit ose kontrata e ndërtimit është në zbatim e sipër.

Shoqëriaduhet të përcaktojë fazën e përfundimit të një transaksioni ose kontrate ndërtimi duke përdorur metodën që mat në mënyrën më të besueshme punën e kryer. Të ardhurat nga kontratat e shërbimeve dhe të ndërtimit përbëhen nga:

- (a) shuma e pagesës fillestare të vendosur në kontratë;
- (b) ndryshimet në volumin e punës që ndodhin gjatë realizimit të kontratës, kërkesat për zhdëmtim, si dhe pagesat stimulueseshtesë, vetëm atëherë kur:
  - (i) ato mund të sjellin të hyra për njësinë ekonomike;
  - (ii) mund të maten me besueshmëri.

### **3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi për fondet e investuara, huatë tek njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet, humbjet nga kursi i këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3.8 Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtëpërsëdrejti në kapital ose të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

#### *Tatimi aktual*

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose i arkëtueshëm mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës ose në datën e raportimit, dhe të gjitha ndryshimet e detyrimeve të tatimit për vitet e kaluara.

#### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime fiskale.

Aktivitetet për tatime të shtyra njihen për humbje tatimore të papërdorur dhe diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion për tu përdorur kundrejt tyre.

Legjislacioni tatimor shqiptar, i miratuar ose në zbatim në mënyrë substanciale në datën e raportimit, është subjekt i interpretimeve të ndryshme në lidhje me aplikimin mbi transaksionet dhe aktivitetet e shoqërisë. Rrjedhimisht, trajtimet tatimore të vendosura nga menaxhimi dhe dokumentacioni zyrtar mbështetës mund të kundërshtohen nga autoritetet tatimore.

Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat, të përcaktuara nga menaxhimi, të cilat ka më shumë gjasa që të mos rezultojnë në vendosjen e taksave shtesë nëse vendimet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në fuqi në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo çështje gjyqësore të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjokat, interesat dhe tatime të tjera mbi fitimin njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit për shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese.

### **3.9 Përfitimet e punonjësve**

#### *Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve*

Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve njihen si shpenzim kur ofrohet shërbimi i lidhur me to. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet nëse shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kaluar të ofruar nga punonjësi dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

#### *Pensionet e detyrueshme*

Shoqëria, gjatë rrjedhës normale të biznesit, bën pagesa për llogari të vet dhe punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet e detyrueshme sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të Shoqërisë njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**Covid 19**

Që nga dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka ndikuar rëndë në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset po detyrohen të ndërpresin ose kufizojnë operacionet për periudha të gjata ose të pacaktuara kohore. Masat e marra për të përmirësuar përhapjen e virusit kanë shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në një ngadalësim ekonomik. Tregjet globale të aksioneve kanë provuar gjithashtu një paqëndrueshmëri të madhe dhe një dobësim të ndjeshëm. Qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjigjur me ndërhyrje monetare dhe fiskale për të stabilizuar kushtet ekonomike. Ndërsa Shoqëria operon në Projektimin dhe ndertimin "me çelsa në dorë" të zyrave dhe infrastrukturave, ne veçanti në sektorin sanitar dhe operacionet e saj nuk janë ndërprerë nga situata. Në datën e hartimit të këtyre pasqyrave financiare drejtimi nuk pret ndonjë ndikim financiar të rëndësishëm negativ pas shpërthimit të Koronavirusit për vitin aktual.

**3. Aktive monetare dhe ekuivalente e tyre**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Banka në Lek	3,538,043	19,225,733
Banka në Euro	163,455,375	111,928,148
Arka	32,243	56,846
<b>Totali</b>	<b>167,025,661</b>	<b>131,210,726</b>

**4. Llogari të arketueshme dhe të tjera të arketueshme**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
PIU Ministria e Shendetesise	98,238,091	56,685,813
Agikons	925,466	473,308
FINSO	2,514,022	2,183,841
<b>Totali</b>	<b>101,677,578</b>	<b>59,342,962</b>

**5. Llogari të arketueshme dhe të tjera të arketueshme**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Garanci per nenkontraktore te ndryshem	12,172,245	12,540,256
Parapagim tatim fitimi	22,176,497	17,377,644
Parapagime te tjera	83,970	18,540
<b>Totali</b>	<b>34,432,712</b>	<b>29,936,440</b>

**6. Shpenzime te shtyra**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Shpenzime te periudhave te ardhme	69,244,452	73,387,464
<b>Totali</b>	<b>69,244,452</b>	<b>73,387,464</b>

**7. Aktivitet afatgjata materiale**

	<b>Paisje informatike dhe të tjera</b>	<b>Paisje zyre dhe të tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>			
Më 1 Janar 2020	937,192	543,049	<b>1,480,241</b>

**INSO ALBANIA sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiarepërvitin e mbyllurmë 31 Dhjetor 2021***(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

Shtesa	134,250		<b>134,250</b>
Pakesime			
Më 31 Dhjetor 2020	<b>1,071,442</b>	<b>543,049</b>	<b>1,614,491</b>
Shtesa			
Pakesime			
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>1,071,442</b>	<b>543,049</b>	<b>1,614,491</b>
<b>Amortizimi</b>			
Më 1 Janar 2020	<b>311,108</b>	<b>183,225</b>	<b>494,333</b>
Shtesa	162,964	71,965	<b>234,929</b>
Pakesime			
Më 31 Dhjetor 2020	<b>474,072</b>	<b>255,190</b>	<b>729,262</b>
Shtesa	146,746	57,572	<b>204,318</b>
Pakesime			
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>620,818</b>	<b>312,762</b>	<b>933,580</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>			
Më 31 Dhjetor 2020	<b>597,370</b>	<b>287,859</b>	<b>885,229</b>
Më 31 Dhjetor 2021	<b>450,624</b>	<b>230,287</b>	<b>680,911</b>

**8. Aktivet afatgjata jo-materiale**

	<b>Aktivi</b>	
<b>Kosto</b>		
Më 1 Janar 2020		220,360
Shtesa		0
Më 31 Dhjetor 2020		<b>220,360</b>
Shtesa		
Pakesime		<b>220,360</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>		
<b>Amortizimi</b>		
Më 1 Janar 2020		<b>40,486</b>
Shtesa		26,981
Më 31 Dhjetor 2020		<b>67,467</b>
Shtesa		<b>23,837</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>		<b>91,304</b>
<b>Vlerakontabël neto</b>		
Më 31 Dhjetor 2020		<b>152,891</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>		<b>129,054</b>

**9. Llogari të pagueshme**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Finso Spa	88,188,101	90,335,111
Agikons	81,234,515	37,164,758
Te tjera	53,386,795	12,294,331
<b>Totali</b>	<b>222,809,411</b>	<b>139,794,200</b>

**10. Llogari të pagueshme dhe te tjera te pagueshme**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Te pagueshme per sigurime shendetesore e shoqerore	243,282	219,311

Te pagueshme ndaj punonjesve per paga	58,919	
<b>Totali</b>	<b>302,201</b>	<b>219,311</b>

**11. Te pagueshme per detyrimetatimore**

	2021	2020
Të pagueshme per TVSH	811,047	1,841,272
Të pagueshme për tatim ne burim	14,914	332,691
Të pagueshme për tatim page	256,529	264,906
<b>Totali</b>	<b>1,082,490</b>	<b>2,438,869</b>

**12. Llogari të pagueshme dhe te tjera te pagueshme**

	2021	2020
Diferenca e rivleresimit te te ardhurave sipas SKK 8, perdorur metoda Cost to Cost	19,666,605	0
<b>Totali</b>	<b>19,666,605</b>	<b>0</b>

**13. Llogari të pagueshme per shpenzime te konstatuara**

	2021	2020
Shpenzime te kontatuara per fatura ne mberritje	4,603,464	0
<b>Totali</b>	<b>4,603,464</b>	<b>0</b>

**14. Te ardhura te shtyra**

	2021	2020
Parapagime nga klientin Ministria e Shendetesise	54,261,226	55,582,261
<b>Totali</b>	<b>54,261,226</b>	<b>55,582,261</b>

**15. Kapitali i paguar**

Kapitali i paguari shoqërisë në 31 Dhjetor 2021 është 4,000,000 Lekë (2020: 4,000,000 Lekë). Gjate vitit 2021 nuk ka ndryshime ne kapitalin e paguar.

	% e pjesëmarrjes	Vlera nominale në Lek
Më 1 Janar 2021	100%	4,000,000
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>100%</b>	<b>4,000,000</b>
Në %		

**16. Të ardhurat**

	2021	2020
Sherbime ndertim vepra civile	543,582,141	340,106,352
<b>Totali</b>	<b>543,582,141</b>	<b>340,106,352</b>

**17. Shpenzime të personelit**

	2021	2020
Pagat dhe shperblimet	-18,224,528	-19,205,774



**INSO ALBANIA sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiarepërvitin e mbyllurmë 31 Dhjetor 2021***(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	-1,596,379	-1,539,963
<b>Totali</b>	<b>-19,820,907</b>	<b>-20,745,737</b>

-

**18. Shpenzime të tjera shfrytëzimi**

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Bl.energji,avull,uje	1,471,422	2,602,671
Situacion punime_Agikons A1	0	15,353,544
Situacion punime_Termoimpianti	3,994,560	0
Situacion punime_Agikons_A2	445,319,801	232,231,361
Situacion punime_DDAIR Group_A2	60,949,445	0
Situacion punime_Albaelettrica_A2	8,952,791	0
Furnizime_Biometric	0	685,470
Shpenzime garancie sipas marreveshjes A2	4,604,072	6,350,639
Shpenzime komisionimi sipas marreveshjes A2	8,368,799	4,953,728
Hekur	0	28,661,723
Beton	6,705,449	31,582,687
Te tjera	14,033,654	12,005,049
<b>Totali</b>	<b>554,399,992</b>	<b>334,426,872</b>

**19. Të ardhura financiare të tjera**

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Fitime nga kursi i këmbimit	2,739,712	3,611,891
Humbje nga kursi i këmbimit	-3,240,893	-3,437,844
Shpenzime per komisione bankare	-48,007	-68,154
<b>Totali</b>	<b>-549,187</b>	<b>105,893</b>

**20. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021është 15% (2020 :15%).

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Fitimi/(humbja) e vitit	<b>-31,416,100</b>	<b>-15,222,275</b>
Shpenzime të tjera të pazbritshme	6,685,763	990,185
<b>Fitimi/(humja) e tatueshme për vitin</b>	<b>-24,730,337</b>	<b>-14,232,090</b>
<b>Shpenzimi i tatim fitimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Fitimi pas tatim fitimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por fitimet apo humbjet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

**21. Palë të lidhura**

Gjatë kryerjes së veprimtarisë normale të biznesit, shoqëria kryen transaksione me palet e lidhura. Shoqëria kryen transaksione me shoqërinë mëmë të saj dhe me filialet e saj. Balancat dhe transaksionet e shoqërisë me palët e lidhura në datën e bilancit janë si më poshtë:

	<b>Marrëdhënia</b>	<b>31 Dhjetor2021</b>	<b>31 Dhjetor2020</b>
<b>Te drejtat</b>			
<b><u>Llogari te arketueshme</u></b>			
	FINSO Spa	2,514,022	2,183,841
<b><u>Llogaritëpagueshme</u></b>			
	FINSO Spa	88,188,101	90,335,111
 <b>Pasqyra e performances</b>			
<b><u>Te ardhura indirekte</u></b>			
	FINSO Spa	321,630	714,362
<b><u>Shpenzime rrjedhëse</u></b>			
Furnizime pajisje	FINSO Spa	0	0
Shpenzime komisionimi	FINSO Spa	8,368,799	4,953,728
Shpenzime garancie	FINSO Spa	4,604,072	6,350,639

## **22. Ngjarje pas periudhës së raportimit**

Ne Shkurt të vitit 2022, Rusia nisi një konflikt ushtarak në Ukrainë. Konflikti aktual mendohet të ketë një impakt negativ në sektorë të ndryshëm.

Kompania nuk mund të vlerësojë impaktin potencial në pasqyrat financiare të saja, megjithatë bazuar ne kontratat me klientet, kompania do të mund t'i mbulojë kostot dhe të vazhdojë aktivitetin e saj. Kompania e konsideron këtë rast si një ngjarje të pa-sistemueshme pas datës së bilancit dhe kjo nuk sjell asnjë impakt në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve në datën e raportimit të pasqyrave financiare.

Pas datës së raportimit të pasqyrave financiare nuk do të ketë ngjarje që do të kërkojnë sistemime ose shtim informacionesh të reja në pasqyrat financiare.